



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 250/prot.

B.Curri, më 10. 9. 2025

VENDIM

Nr. 49 , datë 04.09. 2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL TË RISHIKUAR TË BASHKISË
TROPOJË PËR PERIUDHËN 2025-2027**

Në mbajtje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen e shitësit" (i ndryshuar) nenet 3, 8/2, 24, 54/k; Ligjit Nr. 44/2015, datë 30. 04. 2015 "Kodi i Procedurës Administrative në RSH", Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", nenet 4, 6, 26, 27, 36, 37, 46, 47; Ligji 57/2019 "Për asistencensociale në Republikën e Shqipërisë" (e ndryshuar); Ligjit 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në familje" (i ndryshuar; Ligjit 9970, datë 24.07.2008 "Për barazi gjinore në shoqëri"; Ligjit 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"; Ligjit Nr.22/2018, datë 03.05.2018 "Për trajtimin social", (i ndryshuar); VKM nr. 111, datë 23.02.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social"; VKM nr. 224, datë 09. 04. 2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror", V.K.M 152 datë 13.03.2024 "Për miratimin e strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 dhe planin e veprimit në zbatimin e saj", Këshillit Bashkiak Tropoje sipas propozimit të Kryetari i Bashkisë Tropojë, dhe të Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Social të Bashkisë së Tropojës (të rishikuar) për periudhën 2025-2027, sipas raportit të përbashkët.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Plani Social, Sektori i Shërbimit Social pranë Bashkisë së Tropojës.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 55, pika 6 (i ndryshuar).

Shpallur me 08.09.2025, Miratuar me 12 Vota, Vota 12 Pro, Vota 0 Kunder, Vota 0 Abstenim

SEKRETARI

Ergent GJONGECAJ

KRYETARI

Arber ÇAKRAJ

